



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:129634  
Datë: 14.05.2024  
Numri i dokumentit: 05679815

**PAKR.nr.262/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda**, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi - kryetar i kolegjit, Afërdita Bytyçi dhe Xhevdet Abazi - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtori profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.H. nga fshati R., Rr. “F.U.”, nr. ..., Komuna V. për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarit L.U. nga fshati R., Rr. “S.U.”, Komuna e V., për shkak të veprës penale, ndihmë në kryerjen e veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit E.H., av. F.B., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.372/2023, të datës 22.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HUDHET** si e palejuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.H., av. F.B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.372/2023 të datës 22.03.2024.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.372/2023 të datës 22.03.2024, të akuzuarin E.H. e ka shpallur fajtor për veprën penale, në bashkëkryerje, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar më dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, e 4 (katër) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke i llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 07.06.2023 e deri më datën 06.07.2023. Po me të njëjtin aktgjykim i akuzuari L.U. është shpallur fajtor për veprën penale, ndihmë në kryerjen e veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe është gjykuar më dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili dënim me pëlqimin e tij, i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) euro, në pajtim me nenin 44 të KPRK-së, të cilin dënim me gjobë i akuzuari është obliguar t’ a paguaj në afat prej 15 nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pajtim me nenin 79 të KPRK-së, koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 07.06.2023 e deri më datën 06.07.2023, të akuzuarit i është llogaritur në dënimin e shqiptuar. Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par.3, të KPRK-së, do t’ a zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Të akuzuarit E.H. dhe L.U., janë obliguar që secili veç e veç, t’ i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëqind (100) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro.

Është urdhëruar konfiskimi i përhershëm i 4296 copë monedhave prej 2 euro në vlerë prej 8592 euro, të cekura si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këto monedha duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësja e të akuzuarit E.H., av. F.B., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës t’ a aprovoi si të bazuar ankesën, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t’ a ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që të akuzuarit E. t’ i shqiptoj një dënim me të butë.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.242/2024, datë 02.05.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.H., av. F.B., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, analizoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se:

### **Ankesa nuk është e lejuar.**

Në bazë të vetë ankesës por edhe shkresave tjera në lëndë, rezulton se në këtë çështje penalo-juridike, para ngritjes së aktakuzës palët kanë negociuar marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe pasi që palët kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, të njëjtën marrëveshje në formë të shkruar i'a kanë propozuar gjykatës së shkallës së parë së bashku me aktakuzën, e cila pasi ka vepruar konform dispozitave të nenit 230 par.17 të KPPK, ku ka përcaktuar se në rastin konkret i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, e po ashtu pa kurrfarë detyrimi apo presioni tjetër, se pranimi i fajësisë po ashtu ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura nga prokurori dhe të pranuar nga i akuzuari dhe se nuk ka rrethana të cilat pengojnë ndjekjen penale të parapara nga neni 248 par.1 të KPPK-së, pra, si shkaqe për hudhje të aktakuzës, gjykata e shkallës së parë pasi është bindur se janë plotësuar të gjitha kushtet e cekura si më lartë, me aktvendim ka aprovuar marrëveshjen me shkrim për pranim fajësie të paraqitur nga Prokuroria dhe i akuzuari E.H. me pëlqimin edhe të mbrojtëses se tij, av. F.B.

Në marrëveshje të parashtruar me shkrim para gjykatës, ndër të tjerat palët kanë paraparë, po ashtu, edhe dispozitën e cila ka paraparë kufijtë e shqiptimit të dënimit për veprën penale për të cilën i akuzuari e ka pranuar fajësinë – kuptohet në bazë të marrëveshjes për pranim fajësie, ku palët janë pajtuar edhe për kufijtë e dënimit, ashtu që dënimi që do të shqiptohet nga gjykata për të akuzuarin E.H., për veprën penale, në bashkëkryerje, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, do të jetë dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, e 4 (katër) muaj, pra, kanë vepruar konform dispozitave të nenit 230 par.12 të KPPK-së, në të cilën parashihet mundësia që palët në marrëveshje për pranim fajësie të përfshijnë edhe dispozitën ku palët janë pajtuar për kufijtë e dënimit që do të propozohet nga ana e prokurorisë.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit E.H., av. F.B. lidhur me vendimin mbi dënim.

Në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit E.H., av. F.B., pretendon se dënimi me burg i shqiptuar nga gjykata shkallës së parë në kohëzgjatje prej 1 vit e 4 muaj është shumë i lartë duke pasur parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë që është rrethanë posaçërisht lehtësuese, se është i gjendjes se dobët ekonomike, nuk ka ra në kundërshtim me ligjin asnjëherë më parë por as pas këtij rasti nuk zhvillohet procedurë penale ndaj tij. Më tutje në ankesë mbrojtja ka theksuar faktin se edhe pse janë pajtuar me lartësinë e dënimit, kanë ushtruar ankesë lidhur me lartësinë e dënimit pasi që i akuzuari është mbajtës i familjes, babai i një fëmiu dhe konsideron se nuk janë marrë parasysh disa rrethana lehtësuese dhe atë bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën dhe organet e ndjekjes, keqardhjen e shfaqur, faktin së është mbajtës i familjes, familjar, prind i një fëmiu, mjetet-të hollat janë konfiskuar nga organet kompetente, i akuzuari më nuk ka kryer asnjë vepër tjetër penale dhe nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë tjetër penale ndaj tij. Konsideron se gjykata është dashur të vlerësoj drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese të numëruara në aktgjykimin e ankimuar po edhe këto të theksuara në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim më të ulët, me të cilin do të arrihej në tërësi qëllimi i dënimit, andaj edhe ka propozuar si më lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh të cekurat si më lartë, pra, se palët në marrëveshjen me shkrim për pranim fajësie përveç dispozitave të tjera kanë paraparë edhe kufijtë e shqiptimit të dënimit dhe se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka shqiptuar dënimin në kuadër të kufijve të paraparë me marrëveshje për pranim fajësie, atëherë rezulton se ankesa e mbrojtësit të akuzuarit në rastin konkret është e palejuar, ngase, në bazë të dispozitave ligjore të parapara për negociimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë (neni 230 par.12 të KPRK), palët kanë të drejtë ankese në vendimin mbi dënim ndaj aktgjykimin të marrë në bazë të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë vetëm në raste të caktuara dhe atë vetëm në rastet kur gjykata shqipton dënim jashtë kufijve të paraparë në marrëveshje për pranim fajësie, atëherë palët kanë të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënim.

Në bazë të dispozitës në fjalë, rezulton se në rastet kur me marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë parashihen kufijtë e shqiptimit të dënimit nga palët dhe gjykata shqipton dënime brenda kufijve të paraparë për dënim, atëherë palët nuk kanë të drejtë ankese mbi vendimin mbi dënim.

Në rastin konkret siç del nga shkresat e lëndës, respektivisht nga marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë, prokuroria i ka rekomanduar gjykatës që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, e 4 (katër) muaj, me të cilin dënim i akuzuari dhe

mbrojtësja e tij janë pajtuar, e përveç kësaj në kuadër të drejtave nga të cilat është hequr dorë e të cilat janë përfshirë në marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë, përveç të drejtës për shqyrtim gjyqësor del se i akuzuari ka hequr dorë edhe nga të gjitha të drejtat në lidhje me shqyrtimin gjyqësor.

Nga arsyet e lartcekura, e në bazë të nenit 400 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda**  
**PAKR.nr.262/2024, datë 14.05.2024**

**Bashkëpunëtori Profesional**

**Kryetari i kolegjit**

---

**Bajram Rexhahmetaj**

---

**Burim Ademi**

**Anëtarët e kolegjit:**

---

**Afërdita Bytyçi**

---

**Xhevdet Abazi**